



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 060/01-21074/21  
Kaçanik, 30.07.2021

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII-të (Tetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 30.07.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 26 anëtarë, në ndërkohë erdhi edhe anëtarja Albana Lika (Troni), kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje janë 27 anëtarë-të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtori i drejtoreve komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi dhe Fatlume Guri-Selimi.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII-të (Tetë) të Rregullt për vitin 2021, data 30 Korrik, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020;
3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020;
4. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;
5. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për periudhën: Janar-Qershori 2021;
6. Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e Vendimit të KK të datës 30.06.2021, që ka të bëjë me ndryshim plotësimin e vendimit të KK për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
7. Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e vendimit të KK të datës 15.06.2021 -për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;

8. Kërkesa e MAPL lidhur me Vendimin e KK të datës 15.06.2021 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronën private 01003-0 ZK Kaçanik të Misim Sopa, për këmbim me pronën komunale 01030-0; dhe
9. Propozim Vendimi për Harmonizimin e Vendimit të KK të datës 30.06.2021- për ndryshim plotësimin e vendimit 01.nr.104/02-36179/19 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesës së MAPL.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### Aprovoj

**Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me disa gabime teknike të paraqitura nga Ekrem Kyçyku, Hajredin Luta dhe Agim Mani. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së VII-të (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.06.2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-17392/21.**

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës i korrigjuar.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me kaluar në pikët e dytë, procedojmë me;

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Ekrem Kyçyku**, Faleminderit kryesues, iu përvendoset përgjithëse;

1. Ka shumë keqpërdorues të ujtit të pijes duke larë rrugët me ujë, ndërsa ne lagjet që jetojmë në lartësi të qytetit, nuk kemi ujë të pijes. Kërkoj të merren veprime të nevojshme si qeveri komunale ndaj keqpërdoruesve të ujtit të pijes.
2. Jeta është bërë e padurueshme për jetesë për banorët të cilët jetojnë buzë lumbit Neredime nga Kaçaniku, Kaçanik të Vjetër, Stagovë dhe Runjevë nga kundërmimet që vijnë përmes lumbit Neredime. Mjafton me dalë në mbrëmje përreth lumbit dhe dëgjuar aromën kundërmuese. Shumë herë e kemi ngritur këtë çështje, ndoshta nuk është dashur me u bërë bashkimi i qytetit, të Ferizajt me 8 milion euro. Më mirë do të ishte që Komuna e Ferizajt këto mjete me i investuar në ndërtimin e impiantit.

**z. Selim Reka**, Faleminderit kryesues, përvendoset përgjithëse;

Si rezultat i pandemisë e dimë së nuk kanë funksionuar pishinat dhe sallave të dasmave. Unë e kam një propozim për Ekzekutivin e Komunës; Kërkoj të shikoj mundësinë që së paku t'i liroj nga pagesa e tatimit në pronë, pishinat dhe sallat e dasmave.

**z. Bekim Koxha**, Faleminderit kryesues, përvendoset përgjithëse;

Unë e kam një Vërejtje dhe një Ankesë të qytetarëve të f. Doganaj –konkrektisht të Soponicës. Është shqetësuese dhënia e lejes së hidrocentralit nga Ura e Banovinës në drejtim të Rekës deri në Soponicë, të Provolutë. Unë e di që Kuvendi i Komunës në vitin 2015, ka marrë vendim për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e hidrocentralit për 1.3 MW deri të Ura e Banovinës.

Ndërsa për dhënën e lejes prej Urës së Banovinës e deri të Provolitë, nuk ka marrë kurrfarë vendimi Kuvendi i Komunës, mirëpo është formuar një komision, me çka është anashkaluar vendimi i kuvendit, dhe pse nuk është sjellë këtu në kuvend ai vendim, por është dhënë një Pëlqim për ndërtimin e atij hidrocentrali. Janë mbledhur disa nënshkrime të banorëve të lokalitetit të Soponicës dhe nuk janë marrë për bazë absolutisht ato nënshkrime e reagime të qytetarëve, por është lëshuar pëlqim. Kërkoj të marrë informacion me shkrim nga drejtoria e Urbanizmit së ku qëndron problemi i këtij hidrocentrali dhe pse nuk përfillen kërkesat e qytetarëve të lokalitetit të Soponicës. Nëse i epet leja atij hidrocentrali, unë mendoj që qytetarët e Soponicës nuk kanë pse të rrinë më në atë fshat. Hidrocentrali duhet largohet nga aty, sepse nëse edhe uji i merret atij lokaliteti, atëherë ku do të vendosën ata pa ujë, se për atë ujë qëndrojnë aty dhe ato toka ujitën me atë ujë. Kërkoj që drejtoria e Urbanizmit, Kryetari i Komunës mos të lejojnë absolut që ajo leje të epet dhe kërkoj të anulohet ai pëlqim për ndërtimin e hidrocentralit. Faleminderit.

**z. Besim Vishi,** Përshëndetje, Unë po e ri përsërisë kërkesën për vendosjen e pengesës në rrugë në asfalt të punëtoria e Nesret Vishit. Kjo kërkesë ka 2 vite që është duke u përsëritur. Është vendosur një pengesë të shkolla, por shumë me e rrezikshme është kjo pjesa e rrugës të punëtoria e Nesret Vishit. Aty degëzohet rruga për Qorraj, aty është një shitore, aty ndalet autobusi në parking për zbrazjen e udhëtarëve, aty është punëtoria e Nesretit të cilët i parkojnë kerret lidhje e pa lidhje dhe është shumë e rrezikshme ajo pjesë e rrugës. Tash edhe numri i gurbetçarëve e ka bërë rrugën edhe me të frekuentuar. Kërkoj të shqyrtohet kjo çështje dhe të bëhet një zgjidhje në atë pjesë të rrugës.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka-** Përshëndetje për të gjithë; E kam një kërkesë për drejtorin e Arsimit; Me ndërtimin e shkollës në Dushkajë, është marrë vendim që nxënësit andej hekurudhës të vijojnë mësimin në atë shkollë. Mirëpo kjo nuk po ndodhë. Kush po ka ndonjë lidhje, fëmijët e tyre po vijojnë mësimin në këtë shkollën tjetër. Kjo ka ndodhë në mosmarrëveshje mes prindërve. Unë njoh edhe familjarë që janë fqinjë, ndërkaq fëmijët e njërit mësojnë në Dushkajë, ndërkaq të tjetrit vijojnë mësimin në këtë shkollën tjetër (Emin Duraku – shkolla amë). Kërkoj nga drejtori që të merr një vendim, për këtë çështje, sepse të gjithë fëmijët duhet trajtuar në formë të barabartë.

**znj. Nazife Krasniqi,** Përshëndetje për të gjithë; Unë e kam një Kërkesë për drejtorin e DSHPE; Me intereson të di rruga, me herët është quajtur “Emin Duraku”, tanë quhet “Qamil Ilazi”, kur do filloj punimet e kësaj rruge ? Sa e di unë, që një kohë ka ardhur një mjet pune aty ekskavator, ka qëndruar aty një kohë dhe tanë e kanë larguar. Me intereson të di, kur do të filloj punimet kjo rrugë, sepse dikur mund të bëhet vonë realizimi i këtij projekti.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, përgjigjet besoj se do t'i merrni në mbledhjen e radhës, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Besoj së materialin e keni marrë, e keni pa raportin, raportin e kemi sjellë në KK sa për diskutim,, nëse ka kush diçka , e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku,** Faleminderit kryesues; Në Raportin e Auditorit, shihet se auditori ka audituar pasqyrat vjetore financiare, ku ka gjetur 6 vërejtje, disa prej të cilave përsëritën nga viti 2019. Po filloj nga e gjetura e parë: Çështja : A1 -Shpalosja e të hyrave dhe detyrimeve kontingjente ne PVF. Çështja A2 -Mangësi në përbushjen e kërkesave ligjore, Çështja C1 -

regjistrimi i të hyrave në kode jo adekuate. Çështja A3 -Dobësi në menaxhimin e kontratës, Çështja C1- regjistrimi i të hyrave në kode joadekuate ekonomike, Çështja A3 -Dobësi në menaxhimin e kontratës. Këtu bëhet fjalë për kontratën për zgjerimin e rrugës "Avdurrahim Shehu" në vlerë prej 199,935€. Këtu menaxheri i kontratës ka aprovuar ndryshime pa miratim paraprak të zyrtarit kryesor administrativ. Sasitë sipas specifikacionit teknik të pozicioni 8' furnizimi dhe vendosja e asfalt- betonit me trashësi 6cm, përpunimit të trotuarit me gjerësi 1,40 m ishin 2016mm2, ndërsa sipas librit ndërtimor ishin realizuar 1836m2 apo 180m2 me pak. Këto ndryshime janë bërë pa aprovimin e zyrtarit kryesor administrativ, dhe ky pozicion është kalkuluar për pagesë si i plotë. Po ashtu është nënshkruar aneks kontratë, ku 6 pozicione kishin pësuar ndryshime të theksuara të sasive, për kundër që vlera totale e kontratës nuk është ndryshuar. Në mbledhjen e KPF ne morëm arsyetime, mirëpo letra thotë kështu. Kur ndryshohet diçka, është mirë me na sjellë elaborime për këtë çështje. Çështja C2 -mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosja e informatave në PFV dhe çështja B1 – rritja e llogarive të arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PVF. Nga raporti i auditimit për PVF 2019 janë dhënë rekomandime të cilat deri në fund të vitit 2020 janë zbatuar 5, gjysma, 1 nuk është zbatuar fare, 2 pjesërisht dhe 2 nuk aplikohen më. Për të gjitha këto të gjetura, janë dhënë rekomandimet për Kryetarin e Komunës, shpresojmë që kryetari këto parregullsi t'i zbatoj.

**z. Adnan Reka,** Përshëndetje për të gjithë; Edhe vitin e kaluar kishim një Opinion të Pamodifikuar me Theksim të Çështjes nga Auditori për të njëjtën arsyë, Pagesa nga kategori ekonomike joadekuate 295,784 € janë paguar nga mallra dhe shërbime ne kategorinë paga dhe mëditje për shujtat dhe pagat jubilare në arsim dhe shëndetësi. (sepse të gjitha Komunat atë kohë kishin marrë obligim nga shefi). Shumën prej 38,484€ për shpronësime, pse nuk i keni planifikua nga investimet kapitale, por i keni marre nga mallrat dhe shërbimet, këto është dashtë t'i planifikoni. Përveç shumë gjetjeve tjera të Auditorit që edhe përsëriten nga viti në vit, unë dua të ndalem te Investimet Kapitale, më saktë te Çështja A3 - Dobësi në Menaxhimin e Kontratës. Auditori thotë: Ne identifikuam se për projektin, Zgjerim i rrugës "Avdurrahim Shehu" e nënshkruar më 23.07.2020, në vlerë prej 199,935€, menaxheri i kontratës kishte aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari kryesor administrativ. Kush është ai menaxher që guxon të aprovoj ndryshim të pozicioneve pa lejen e Kryetarit ? Unë mendoj se ju Kryetar, jeni treguar pak më i mençur se ish Kryetari i Istogut, Haki Rugova. Auditori ka theksuar se, Sipas librit ndërtimor nga 2016 m2 asfalt beton sa ishte paraparë për ndërtimin e trotuarit, vetëm 1836 m2 ishin realizuar, do te thotë 180 m2 asfalt beton janë realizuar më pak, pa aprovimin tuaj, por pagesa nuk ka ndryshuar, është llogaritur si e plotë. Po ashtu, në këtë kontratë ishte nënshkruar edhe Aneks kontrata, ku gjashtë pozicione kishin pësuar ndryshime të theksuara, por vlera totale e kantatës nuk kishte ndryshuar. A e di pse po i theksoj të gjitha këto? sepse për këtë kontratë dhe punimet në këtë rrugë s'ka mbet banorë i lagjes apo qytetarë pa u ankuar, dhe të gjithë e kemi ditë që kjo kontratë me punimet që po zhvillohen janë tepër të dobëta dhe të dyshimta, por vetëm ju Kryetar, nuk e keni ditur. Kur unë kam dhënë vërejtjet e mijë për punimet në këtë rrugë, a e di çfarë ke thënë? kur t 'përfundojë kjo rrugë ka me t 'ardhur turp për këto që po i thua. E tani, unë ju pyes juve Kryetar, kujt i përket turpi? sepse tani edhe auditori e ka konfirmuar, që po bëni punë të dobëta dhe të dyshimta, se jeni plotësisht në shërbim të operatorëve, ama kurrë në shërbim të qytetarëve.

**z. Nexhat Loku,** Faleminderit kryesues; Raporti i Auditorit me vet faktin së është i pamodifikuar me theksim të çështjes, ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur, sepse kanë rënë të gjeturat nga viti në vit. Kështu në vitin 2020 janë vetëm 3 të gjetura, 4 janë nga viti i kaluar. Theksimi i çështjes është kryesisht të pagat jubilare dhe shujtat. Me vet faktin së një Marrëveshje e cila është bërë midis Sindikatës së Arsimit me MF dhe MASHT, pagesa nuk

mund të paragjykohet se përmbaruesi nuk pyet, veç i kërkon paratë me i ekzekutuar tek punëtorët.

**z. Selim Reka,** Faleminderit kryesues; Ne në KPF i kemi dhënë vërejtjet tona, disa sot u përsëritën edhe këtu. Duke analizuar të gjitha raportet e viteve të fundit, komuna në vazhdimësi nga viti në vit ka pasur përmirësimë. Edhe kësaj radhe të gjeturat janë me pak në krahasim me vitet tjera, mirëpo e jona është më kërkuar çdo herë zbatim sa më të madh të gjeturave. Sikur të ishte zbatuar në përpikëri Plani i veprimit i vitit 2019, edhe këto të gjetura të identifikuara në raport nuk do të ishin sot. Shpresojmë në të ardhmen që raporti të jetë edhe më i mirë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti i Auditorit për komunën tonë për mendimin tim është i mirë, duke krahasuar me komunat tjera. Besoj së është një ndër raportet më të mira që e ka nxjerrë auditori. Është normale që auditori sa herë gjënë të gjetura në se cilën komunë, dhe ato të gjetura është fat i mirë që iu lihen organeve të drejtësisë dhe ato sigurisht trajtohen nga ky organ së a janë ashtu apo jo. Është mirë edhe të vlerësohet dhe të kritikohet çdo raport i auditorit edhe të ekzekutivit pajtohem, në mënyrë që çdo herë raportet e auditorit të dalin sa më të mira për shkak të punës së mirë që duhet me bërë komuna, në mënyrë që me pasur sa më pak të gjetura. Meqë hymë në krahasime, mundemi me bërë krahasim me Istogun, Prizrenin me Kryetarin e Prizrenit Mitaher. E shihni me sa të gjetura është raporti i kësaj komune dhe me çfarë shkeljesh. Meqë u bënë krahasime, se nuk e kisha ndërmend me përmendur, janë krejt të pranueshme ato të cilat u thanë dhe ato të cilat duhet me u përmirësuar në kuadër të asaj se çdo herë duhet bëhet puna sa më e mirë që të dal raporti me sa më pak të gjetura. Ne jemi në rrugë të mirë, sepse sa herë po vjen duke rënë numri i të gjeturave, ndërkaq mirë është mos me pasur të gjetura fare. Nuk e di se ka pasur ndonjëherë ndonjë raport të auditorit pa ndonjë të gjetur në asnjë institucion lokal apo qendror. Unë edhe një herë po e potencoju së e kam vlerësuar së ky raport është një ndër raportet me të mira, krahasuar me raportet e komunave tjera.

**z. Adnan Reka,** Krahasimin që e bëra, e theksova së kryetari jonë u tregua me i mençur se nuk e ka aprovuar kontratën, ndërkaq i kryetari i Istogut u tregua pak me i dobët se e ka aprovuar kontratën, ky ishte dallimi. Sa i përket raportit, se kush e ka raportin më të mirë, unë e shikoj raportin e komunës tonë, ndoshta ju i shikoni edhe raportet e komunave tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, raporti është sa për informatë, Atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

**Njoftua**

**Me Raportin e Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 470/03-20625/21.**

3. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2020;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në kuadër të raportit të auditorit, Ekzekutivi i Komunës është i obliguar të hartoj një Plan Veprimi për të zbatuar rekomandimet e raportit të auditorit. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka,** Po ndërlidhem me të gjeturat si në raportin e auditimit, nga të gjeturat si në raport e auditimit. Për vitin 2019, nga 10 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar Pra, për herë të parë komuna jonë ka arritur të zbatoje vetëm gjysmën e rekomandimeve të auditorit, a duhet ti gëzohemi këtij fakti? Pra, ky është niveli jonë kur të arrijmë ta kryejmë

gjysmën e punës jemi shumë të lumtur se për ta përfunduar me sukses as që behët fjalë. Paramendoni se në çfarë gjendje e keni sjell komunën.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Disa nga të gjeturat janë të përsëritshme gati të gjitha komunat, si të kontrata kolektive nuk ka qenë obligim i komunave, ndërkaq është cilësuar si e gjetur në të gjitha komunat. Qysh ka me u eliminuar kjo e gjetur, ndërkaq ka të gjetura të cilat janë të arritshme me u eliminuar.

**z. Adnan Reka,** Unë e kisha në konsideratë tërë ato të cilat ndodhin në krejt komunat, edhe auditori kishte me bërë vërejtje dhe i kishin marrë parasysh rrethanat pse ka ndodhur ato të gjetura në të gjitha komunat, por raporti ka edhe të gjetura të tjera të cilat kanë ndodhur.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 (7 anëtarë nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditorit të Zyra Kombëtare, për PFV'2020 / Lënda: 01Nr. 470/03-20635/21.**

**4.** Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, bëhet fjalë për shumat të cilat lëvizin brenda programeve buxhetore gjatë vitit, pasi që nuk po kemi rishikim të buxhetit. Drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin për rialokim të mjeteve buxhetore të vitit 2020 dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarë (7 nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për rialokim të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021 nga kategoria ekonomike - Shpenzime Kapitale, fondi burimorë 10, Në kuadër të Nën-programit buxhetor:, Shërbimet e shëndetësisë primare (74700) nga projekti me kod 48554 ‘‘Blerja e veturave për nevoja të QKMF-së’’ shuma prej 20,000.00€, rialokohet në projektin me kod 50208 ‘‘Rindërtimi i objektit të QMF-së në fshatin Doganaj’’ shuma prej 20,000.00€ / Lënda: 01Nr. 400/03-20752/21.**

**5.** Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për periudhën: Janar-Qershori 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë është i KKSBB i formuar nga KK, ky këshill është i obliguar të sjellë Raportin e punës së tij në KK. Raporti është për periudhën: Janar-Qershori 2021. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

#### Informua

**Me Raportin (Informatë) e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për periudhën: Janar-Qershori 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-20613/21.**

**6.** Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e Vendimit të KK të datës 30.06.2021, që ka të bëjë me ndryshim plotësimin e vendimit të KK për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Siç e dimë ne në mbledhjen e datës 30.06.2021 është ndryshuar dhe plotësuar KPF, ashtu që Hafize Sallahu është hequr nga KPF për të zëvendësuar me Bekim Koxha. Meqë është prishur struktura gjinore e KPF, MAPL e ka kthyer vendimin për me harmonizuar. Mendimi im është të shfuqizohet vendimi i mbledhjes së kaluar dhe të ngelë në fuqi vendimi që ka qenë, pasisë KPF mund t'i ketë edhe tre mbledhje, sepse jemi në fund të mandatit. Për me ri themeluar KPF nuk ka kohë, pasisë vendimi i ri përsëri shkon në shqyrtim ligjor të MAPL. Kërkoj mendimin e juaj. E hapi diskutimin për këtë pikë; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim shfuqizimin e vendimit, Për votuan shumica, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 anëtarë (7 nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për ANULIMIN e Vendimi 01Nr.60/01-18413/21 i datës 30.06.2021 me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018, Vendimi 01Nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe Vendimi 01Nr. 060/01-27538/20 i datës 23.11.2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-20332/21.**

Me marrjen e këtij Vendimi, mbeten në fuqi Vendimi 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 si dhe vendimet për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe 01Nr. 060/01-27538/20 i datës 23.11.2020.

**7.** Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e vendimit të KK të datës 15.06.2021 -për formimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sipas kërkesës së MAPL, ky Vendim duhet të shfuqizohet, sepse nuk është kompetencë e KK formimi i komisionit për ndarjen e banesave. Materialin e keni marrë së bashku me kërkesën e MAPL. Unë mendoj se nuk kemi si te veprojmë ndryshe, pos të shfuqizojmë këtë vendim. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj për votim anulimin e këtij vendimi dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për ANULIMIN e Vendimit të KK 01Nr.60/01-15789/21 të datës 15.06.2021 -për themelimin e komisionit për ndarjen e banesave në banimin social në fshatin Kaçanik i Vjetër/ Lënda: 01Nr. 60/01-21134/21.**

**8.** Kërkesa e MAPL lidhur me Vendimin e KK të datës 15.06.2021 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronën private 01003-0 ZK Kaçanik të Misim Sopa, për këmbim me pronën komunale 01030-0;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë vendimi i KK është marrë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve Lokale, nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Kërkesa e MAPL është të pezullohet ky Vendim. Mendimi im është të shfuqizohet edhe ky vendim, sepse nëse e lëmë pezull, përsëri KK i ardhëm ka me këtë çështje. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka,** Unë jam i mendimit të zgjidhim këtë çështje e mos të lëmë KK të ardhëm këtë problem.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim shfuqizimin e këtij vendimi. Rezultati i votimit ishte, Për votuan shumica, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 anëtarë (7 nga LVV dhe Ekrem Reka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për ANULIMIN e Vendimit të KK 01 Nr. 06-350/02-8304/21 të datës 15.06.2021- për Shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesën e PK 01003-0 ZK Kaçanik, pronë private në emër të Misim Sopa, për Këmbim me pronën komunale me pjesën e PK 01030-0 ZK Kaçanik / Lënda: 01Nr. 60/01-20334/21.

**09.** Propozim Vendimi për Harmonizimin e Vendimit të KK të datës 30.06.2021- për ndryshim plotësimin e vendimit 01.nr.104/02-36179/19 -për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkeseve dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesës së MAPL.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Edhe në këtë rast MAPL ka kërkuar që vendimi të harmonizohet me legjislacionin në fuqi. Drejtori si anëtar i komisionit është prezentë këtu, e ka sjellë draftin e ri të harmonizuar. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Unë kisha dashur me shumë sqarime nga drejtori i DAP.

**z. Festim Neziraj**, Sa i përket pikës të cilën MAPL na e ka kthyer në rishqyrtim, është për shkak të lëshimi teknik të cilin e kemi bërë ne si komision, sepse jemi bazuar në një Udhëzimin Administrativ të vjetër i cili ka qenë i shfuqizuar. Çështje kjo me tepër teknike, sepse nëse i marrim e krahasojmë me Udhëzimin Administrativ të ri, shihet së nuk kanë ndryshime. Çështja tjetër është së, Shtojcën të cilën e keni ju, kur është përgatitur vendimi prej Zyrës së KK nuk është përfshirë në vendim pjesa e shtojcës. Një gjë e tillë nuk do të bëhet përsëri, në mënyrë që çështja të kaloj në MAPL.

**z. Ekrem Kyçyku**, A janë hyrë në këtë Propozim Vendim edhe rrugët tjera të cilat ishin propozuar?

**z. Festim Neziraj**, Jo nuk janë të përfshira, se ne nuk kemi mandat me shtuar rrugë tjera. E jona ka qenë vetëm me harmonizuar vendimin me legjislacionin në fuqi, sipas kërkesës së MAPL.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Arsyja është së ky vendim nuk është ndryshuar në përbajtje, por në bazë, sepse komisioni thirret në një Udhëzimin Administrativ të vjetër, ndërkaq duhet me u thirrur në Udhëzimin Administrativ të ri. Rrugët diskutabile nuk munden me qenë pjesë e këtij vendimi. Ne jemi duke e rishqyrtuar vendimin e mbledhjes se kaluar, në të cilin vendim nuk janë të përfshira rrugët diskutabile. MAPL ka kërkuar që KK me u thirrur në Udhëzimin Administrativ të ri përmarrjen e këtij vendimi.

**z. Ekrem Kyçyku**, Kërkoj 5 minuta pushim për konsultim me subjektin tim politik- LVV.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Pas pauzës prej 5 minutave të KK, konstatoj së vazhdojmë me punimet e mbledhjes. A ka kush ndonjë diskutim rreth kësaj pike ? Për diskutim nuk u paraqit kush tjetër, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 7 Anëtarë: Ekrem Kyçyku, Adnan Reka, Agim Mani, Kaltrina Kodra (Tafili), Fatijona Kyçyku, Albana Lika(Troni) dhe Ekrem Raka. Prezent në

mbledhje janë 26 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës me 2/3 e votave Për, mori këtë,

#### VENDIM

**Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr.104/02-36179/19 -për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, sipas Kërkesës së MAPL/ Lënda: 01Nr. 104/02-21139/21.**

**Me marrjen e këtij Vendimi, Anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 060/01-17365/21 i datës 30.06.2021.**

Në fund Kryesuesi i Kuvendit i njoftoj anëtarët e KK së edhe pse muaji gusht është muaj i pushimeve, në muajin gusht do të mbahet një mbledhje e KK diku nga data 20-deri në fund të muajit. Këtë çështje duhet ta keni parasysh, se mund të jeni ndonjë prej jush në pushime. Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 11:47. Deri fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, pasi që anëtarë Nexhat Luku me lejen e Kryesuesit të Kuvendit doli me herët nga mbledhja.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e VIII-të (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 30 Korrik 2021**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

- Kuvendi i Komunës-

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK**  
(zgjedhur në votimet e 22 Tetorit 2017)

**Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e VIII-të (Tetë) të Rregullt për vitin 2021, mbajtur me 30 Korrik 2021**

1	2	3	4	5
Nr. R	Emri dhe Mbiemri	pozita	Përkatësia Politike	Nënshkrimi
01.	Hamid Guri	anëtar	PDK	
02.	Ahmet Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Besim Vishi	"	Nga PDK/ në LVV	
05.	Sali Malsiu	"	PDK	
06.	Lirije Dema	"	PDK	
07.	Pranverë Loku-Zharku	"	PDK	
08.	Lirije Luta	"	PDK	
09.	Vlora Dalloshi	"	PDK	
10.	Nexhat Loku	"	LVV	
11.	Agim Mani	"	LVV	
12.	Adnan Reka	"	LVV	
13.	Ekrem Kyçiku	"	LVV	
14.	Fatijona Kyçiku	"	LVV	
15.	Kaltrina Kodra	"	LVV	
16.	Selim Reka	"	LDK	
17.	Besnik Salihu	"	LDK	
18.	Nazife Krasniqi	"	LDK	
19.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
20.	Shemsedin Luzha	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) nga GP/ i Pavarur/ i Pavarur nga i Pavarur në LVV-	
21.	Albana Lika	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur(GP) Nga GP në LVV	
22.	Rabije Sallahi	"	AAK	
23.	Hajredin Luta	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur	
24.	Hafize Sallahi	"	Nga NISMA/ në AAK	
25.	Bekim Koxha	"	NISMA	
26.	Ekrem Raka	"	IQ Lista për Kaçanikun	

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

